

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhmenti  
strategjik i biznesit

P12

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 12/10/2024

### **Detyra 1:**

Korporata Orion Tech është një kompani teknologjike që operon në shumë vende të BE-së, e fokusuar në zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve inteligente dhe softuerëve për konsumatorë dhe biznese. Në mbledhjen e fundit të aksionerëve, bordi është udhëzuar të përqendrojë strategjinë në dy drejtime kryesore:

- a) Të fillojë procesin e përgatitjes së të gjitha procedurave të qeverisjes dhe strategjisë korporative për ta bërë gati kompaninë për t'u listuar në bursë;
- b) Të implementojë praktika të qëndrueshme mjedisore, duke reduktuar përdorimin e materialeve të dëmshme dhe duke përmirësuar efikasitetin energetik të produktave.

CEO i korporatës, Arian Kurti, është i njohur për qasjen e tij agresive të biznesit, duke ndjekur rritjen përmes uljes së kostove dhe zgjerimit të shpejtë në tregje të reja, shpesh pa marrë në konsideratë plotësisht aspektet mjedisore dhe sociale. Bordi i drejtorëve udhëhiqet nga Kryetarja Ekzekutive, Ina Bala, e cila shpesh mbështetet te vendimet e CEO-së dhe nuk angazhohet thellësisht në qeverisjen e përditshme të kompanisë.

Çështjet për t'u konsideruar:

Mungesa e përbushjes së detyrimeve mjedisore: Edhe pse aksionerët kanë kërkuar që kompania të përbushë standardet mjedisore dhe të minimizojë ndikimin e saj negativ, CEO dhe bordi nuk kanë ndërmarrë hapa për të implementuar këto ndryshime. Orion Tech vazhdon të përdorë materiale të dëmshme për mjedisin dhe nuk ka arritur të certifikojë produktet e saj sipas standardeve të qëndrueshmërisë mjedisore.

Probleme të cilësisë së produktit: Disa produkte të pajisjeve inteligente të Orion Tech janë tërhequr nga tregu në disa vende për shkak të defekteve që shkaktonin mbinxehje të rrezikshme. Kompania po përballet me padi nga konsumatorët, të cilët pretendojnë se mungesa e paralajmërimeve dhe informacioneve të qarta në paketim ka çuar në dëmtim serioze të pronave dhe shëndetit.

Shfrytëzimi i punës në vendet e prodhimit: Një linjë e produkteve të Orion Tech vazhdon të prodhohet në fabrika në Azinë Juglindore, ku kushtet e punës nuk respektojnë kodet ndërkombëtare të punës, dhe ka raportime se kompania përdor punë të fëmijëve. Pagat janë tepër të ulëta, duke ngjallur shqetësimë për shfrytëzimin e punës dhe shkeljen e të drejtave të punëtorëve.

Marketingu agresiv dhe ndikimi në të rinjtë: Fushatat e marketingut të Orion Tech janë shumë të suksesshme, duke shfrytëzuar mediat sociale për të targetuar të rinjtë. Megjithatë, shumë nga këto fushata theksojnë vetëm avantazhet teknologjike dhe çmimet konkurruese, pa përmendur rreziqet e mundshme të sigurisë së të dhënave dhe problemet mjedisore që lidhen me prodhimin e pajisjeve.

Qeverisja e dobët: Kryetarja e bordit shpesh organizon mbledhjet e bordit pa paralajmërimë të mjaftueshme dhe pa përgatitje paraprake. CEO përgatit të gjitha materialet për mbledhjet e bordit, të cilat zakonisht miratohen pa shumë diskutim. Raportet e auditimit diskutohen vetëm dy herë në vit, dhe komiteti i auditimit përbëhet nga individë që nuk kanë përvojë në fushën financiare.

Auditorët: Firma e auditimit e angazhuar nga Orion Tech është Beta Audit, e cila merr një pjesë të madhe të tē ardhurave nga auditimi i kësaj kompanie. Për më tepër, kjo firmë ka dhënë edhe shërbime konsulencë për blerjen e dy kompanive të tjera të teknologjisë nga Orion Tech, duke ngallur shqetësimë për konfliktin e interesit.

Mospërfshirja e aksionerëve të vegjël: Në mbledhjet e fundit të aksionerëve, aksionerët e vegjël nuk ishin ftuar të marrin pjesë, dhe vendimet e rëndësishme janë marrë pa votat e tyre, me arsyetimin se ndikimi i tyre ishte i papërfillshëm.

Kërkohet:

- a) Duke analizuar teorinë e agjentit, shpjegoni si kjo teori mund të zbatohet në rastin e Korporatës Orion Tech. (10 pikë)
- b) Duke analizuar legjislacionin e "Sarbanes-Oxley Act", diskutoni çështjet kryesore të qeverisjes dhe menaxhimit të Korporatës Orion Tech. (5 pikë)
- c) Cilat janë kërkuesat kryesore që kjo korporatë duhet të përmbushë për t'u listuar në bursë, sipas "Sarbanes-Oxley Act"? (5 pikë)
- d) Duke shpjeguar kodet kryesore të qeverisjes korporative, diskutoni se cilat çështje adresojnë këto kode në kontekstin e Orion Tech. (10 pikë)

Zgjidhja 1:

**a) Teoria e agjentit dhe aplikimi i saj në rastin e Korporatës Orion Tech:**

Teoria e agjentit përshkruan marrëdhënien midis aksionarëve (pronarët) dhe menaxherëve (agjentët), ku agjentët drejtojnë kompaninë në emër të aksionarëve. Problemi kryesor që ngritet është konflikti i interesave midis agjentëve, të cilët shpesh kërkojnë të maksimizojnë përfitimet e tyre personale, dhe aksionarëve, që janë të interesuar për rritjen e vlerës së kompanisë. Në rastin e **Orion Tech**, CEO Arian Kurti dhe Kryetarja Ekzekutive Ina Bala po ndjekin një politikë që nuk përputhet me interesat e aksionarëve, duke injoruar çështjet mjedisore dhe sociale, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin dhe të ardhurat afatgjata të kompanisë. Përveç kësaj, vendimet për të minimizuar përfshirjen e aksionarëve të vegjël përforcojnë këtë mosbalancim të interesave.

**b) Çështjet kryesore të qeverisjes dhe menaxhimit sipas "Sarbanes-Oxley Act":**

"Sarbanes-Oxley Act" (SOX) synon të përmirësojë transparencën dhe integritetin në qeverisjen korporative. Në rastin e **Orion Tech**, disa çështje kyçe janë:

- Auditimi i pavarur:** Firma **Beta Audit**, e cila kryen auditimin për Orion Tech, përbën një konflikt interesit pasi përfiton edhe nga shërbimet e konsulencës për blerjen e kompanive, gjë që është kundër rregullave të SOX.
- Mungesa e komitetit të auditimit të pavarur:** Komiteti i auditimit në Orion Tech përbëhet nga individë të pa përgatitur dhe pa përvojë në financa, gjë që bie ndesh me kërkesat e SOX për një komitet të pavarur dhe të kualifikuar.
- Kontrollet e brendshme:** Kompania ka mangësi të mëdha në menaxhimin e kontolleve të brendshme dhe raportimin financiar, siç tregohet nga mungesa e diskutimeve të thelluara të auditimeve dhe raportet financiare.

**c) Kërkesat kryesore për listimin në bursë sipas "Sarbanes-Oxley Act":**

- Kontrolli i brendshëm i repte:** Korporatat duhet të kenë një sistem të rregulluar të kontolleve të brendshme, dhe menaxhmenti duhet të raportojë mbi efektivitetin e tyre.

**Komiteti i pavarur i auditimit:** Duhet të ekzistojë një komitet auditimi i pavarur, i përbërë nga anëtarë që nuk kanë lidhje me menaxhmentin dhe kanë përvojë të konsiderueshme financiare. Në rastin e **Orion Tech**, komiteti i auditimit është i papërshtatshëm pasi përbëhet nga individë pa ekspertizë financiare dhe që janë të lidhur me menaxhimin.

**Raportimi financiar transparent:** Kompanitë që dëshirojnë të listohen në bursë duhet të paraqesin raporte financiare të plota dhe të sakta. CEO dhe CFO duhet të certifikojnë

personalisht raportet financiare për të garantuar saktësinë e të dhënave dhe mungesën e manipulimeve. Në rastin e **Orion Tech**, ky standard nuk përbushet pasi raportet financiare nuk janë diskutuar nga një komitet i kualifikuar auditimi dhe nuk ka siguri të mjaftueshme mbi integritetin e tyre.

□ **Konflikti i interesit:** Sarbanes-Oxley Act kërkon që kompanitë të eliminojnë çdo konflikt interesit midis auditorëve dhe menaxhmentit. Në këtë rast, **Beta Audit** kryen edhe shërbime konsulente për **Orion Tech**, gjë që përbën një shkelje të SOX dhe duhet të ndalohet për të siguruar pavarësinë e auditorëve.

**d. d) Kodet kryesore të qeverisjes korporative dhe çështjet që adresojnë në kontekstin e Orion Tech:**

**1. OECD Principles of Corporate Governance:**

- **Transparenca dhe Llogaridhënia:** OECD kërkon që kompanitë të kenë procese transparente të qeverisjes dhe të jenë të llogaridhënëse ndaj të gjithë aksionarëve. Në rastin e **Orion Tech**, transparenca mungon pasi aksionarët e vegjël nuk janë përfshirë në vendimmarrje dhe mbledhjet e bordit bëhen pa paralajmërim të duhur. Për të përbushur standardet e OECD, kompania duhet të sigurojë që informacioni financiar dhe vendimet kryesore të ndahen me të gjithë aksionarët, pavarësisht madhësisë së tyre.
- **Mbrojtja e të Drejtave të Aksionarëve:** OECD thekson rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve, përfshirë të drejtën për të votuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. **Orion Tech** ka përjashtuar aksionarët e vegjël nga procesi vendimmarrës, gjë që bie ndesh me parimet e OECD dhe duhet korriguar për të siguruar që të gjithë aksionarët të kenë një zë në kompaninë e tyre.

**2. Cadbury Report (UK Corporate Governance Code):**

- **Pavarësia e Bordit:** Cadbury thekson rëndësinë e pavarësisë së bordit për të siguruar një balance të duhur të pushtetit midis menaxhimit dhe mbikëqyrjes. Në **Orion Tech**, kryetarja **Ina Bala** mbështetet te CEO **Arian Kurti**, duke krijuar një marrëdhënie të varur që dobëson mbikëqyrjen efektive. Përputhja me Cadbury kërkon që një pjesë e madhe e anëtarëve të bordit të jenë të pavarur dhe jo të lidhur me menaxhimin, duke forcuar kontrollin dhe llogaridhënien.
- **Komiteti i Auditimit dhe Pavarësia e Auditorit:** Raporti Cadbury sugjeron që komiteti i auditimit të përbëhet nga anëtarë të pavarur dhe që auditorët të jenë të pavarur nga menaxhimi i kompanisë. Në **Orion Tech**, komiteti i auditimit përbëhet nga individë të pa përvojë dhe auditimi kryhet nga **Beta Audit**, e cila ka një konflikt interesit për shkak të angazhimeve të saj të tjera me kompaninë. Kjo shkelje e Cadbury duhet korriguar duke krijuar një komitet auditimi të pavarur dhe duke zgjedhur auditorë të paanshëm.

### **3. South African King Code (King IV):**

- **Përfshirja e Stakeholderëve (Grupet e Interesit):** King IV thekson rëndësinë e përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara (stakeholders) në qeverisjen e korporatës. Në rastin e **Orion Tech**, dështimi për të marrë parasysh interesat e konsumatorëve (p.sh., për shkak të produktit tërhequr nga tregu) dhe abuzimi me të drejtat e punëtorëve në fabrikat e tyre të prodhimit përbëjnë shkelje të këtij parimi. Kompania duhet të vendosë praktika që respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe konsumatorëve, duke reflektuar një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj përgjegjësisë sociale dhe qeverisjes.
- **Etika dhe Qeverisja e Përgjegjshme:** King IV kërkon që bordi të veprojë me integritet dhe të sigurojë që kompania të ndjekë praktika të qëndrueshme dhe etike. Në rastin e **Orion Tech**, CEO dhe bordi kanë neglizhuar qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale, duke përdorur praktika që shkelin të drejtat e punëtorëve dhe mjedisin. Për t'u përputhur me King IV, kompania duhet të rishikojë politikat e saj për të përfshirë praktika të qëndrueshme dhe etike në të gjithë operacionet.

### **4. Mixed Code (Combination of Various Codes):**

- **Menaxhimi i Rrezikut:** Mixed Code kombinon aspekte nga OECD, Cadbury, dhe King IV, duke përfshirë një fokus të fortë në menaxhimin e rrezikut. Në **Orion Tech**, bordi nuk po menaxhon rrezikun e reputacionit dhe rrezikun ligjor që lind nga produktet me defekte dhe nga praktikat e paligjshme të punës. Për të ndjekur këtë kod, kompania duhet të krijojë një komitet të menaxhimit të rrezikut që përfshin individë të përkushtuar për të identifikuar dhe trajtuar këto rreziqe.
- **Kontrolli i Brendshëm dhe Pavarësia Financiare:** Mixed Code kërkon që kompanitë të kenë kontolle të brendshme të forta dhe komitete të auditimit që janë të pavarura nga menaxhmenti. Në **Orion Tech**, kontrollet e brendshme janë të dobëta dhe komiteti i auditimit nuk është i pavarur. Kompania duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të emërojë një komitet auditimi të pavarur për të përmbrushur këto standarde.

**Detyra 2:**

Korniza e Kontrollit të Brendshëm dhe Qeverisja Korporative

- a) Shpjegoni Kornizën e Kontrollit të Brendshëm sipas Diagramit COSO dhe detajoni veçoritë kryesore të saj. (5 pikë)
- b) Vizatoni diagramin e COSO dhe përshkruani secilin komponent në kontekstin e kompanisë "GreenTech Solutions," një kompani teknologjike që ofron produkte energjje të rionvueshme. (5 pikë)
- c) Përshkruani format më të zakonshme të aktivitetave të kontrollit që mund të instalohen në departamentin e operacioneve në GreenTech Solutions. (5 pikë)
- d) Duke përdorur matricën e Mendelow, klasifikoni palët e interesit të GreenTech Solutions dhe diskutoni fuqinë dhe interesin e secilës prej tyre në vendimmarrje. (5 pikë)
- e) Spjegoni termet e qëndrueshmërisë, gjurmëve mjedisore dhe gjurmëve sociale dhe si lidhen këto koncepte me GreenTech Solutions. (5 pikë)
- f) Përshkruani çfarë nënkupton raportimi i integruar dhe çfarë përfshijnë raportet ESG. Diskutoni si GreenTech Solutions mund t'i zbatojë këto raporte në praktikat e saj. (5 pikë)

## Zgjidhja 2:

a) Shpjegoni Kornizën e Kontrollit të Brendshëm sipas Diagramit COSO dhe detajoni veçoritë kryesore të saj. (4 pikë)

Korniza COSO (Committee of Sponsoring Organizations) është një strukturë që ndihmon organizatat të menaxhojnë rreziqet dhe të përmirësojnë kontrollin e brendshëm. Korniza përbëhet nga pesë komponentë kryesorë:

Mjedisi i Kontrollit: Ky është themeli i sistemit të kontrollit dhe përfshin kulturën e integritetit, etikës dhe përkushtimin ndaj kontolleve të brendshme të organizatës.


Vlerësimi i Rrezikut: Organizata identifikon, vlerëson dhe menaxhon rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të saj.

Aktivitetet e Kontrollit: Këto përfshijnë politikat dhe procedurat që ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve dhe në arritjen e objektivave të organizatës.

Informimi dhe Komunikimi: Organizata duhet të sigurojë që informacioni të jetë i aksesueshëm dhe të komunikojë qartë në të gjitha nivelet përmarrjeve e vendimeve të sakta.

Monitorimi i Aktivitetit: Këto janë proceset që përdoren për të monitoruar efektivitetin e kontolleve të brendshme, duke përfshirë rishikime të rregullta dhe aktivitete korrigjuese.

b) Vizatoni diagramin e COSO dhe përshkruani secilin komponent në kontekstin e kompanisë "GreenTech Solutions," një kompani teknologjike që ofron produkte energjive të rinovueshme. (4 pikë)



Mjedisi i Kontrollit: Në GreenTech Solutions, mjedisi i kontrollit duhet të përfshijë një kulturë të fortë të qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë sociale. Udhëheqësit duhet të theksojnë rëndësinë e inovacionit të pastër dhe etikës në zhvillimin e produkteve të energjisë së rinovueshme.

Vlerësimi i Rrezikut: Kompania duhet të identifikojë rreziqe të tilla si rregullimet mjedisore, ndryshimet teknologjike, dhe kërkesat e tregut për produkte më të qëndrueshme dhe të rinovueshme.

**Aktivitetet e Kontrollit:** Kontrolli i cilësisë së produkteve dhe proceseve prodhuese duhet të jetë i fuqishëm për të siguruar që produktet janë në përputhje me standarde mjedisore. Kjo përfshin instalimin e kontolleve për monitorimin e furnizuesve dhe teknologjisë së përdorur.

**Informimi dhe Komunikimi:** Komunikimi brenda GreenTech Solutions duhet të përfshijë rrjedhën e informacionit nga bordi drejt të gjitha niveleve të organizatës për të garantuar që çështjet kritike për qëndrueshmërinë janë të qarta për të gjithë punonjësit.

**Monitorimi i Aktivitetit:** GreenTech Solutions duhet të monitoroje rregullisht performancën e saj për të siguruar që kontrollet e brendshme për përputhshmërinë mjedisore dhe rregullat e qëndrueshmërisë po respektohen.

c) Përshkruani format më të zakonshme të aktivitetave të kontrollit që mund të instalohen në departamentin e operacioneve në GreenTech Solutions. (4 pikë)

Ndërprerja e detyrave: Detyrat kritike në proceset e operacioneve duhet të ndahen midis punonjësve të ndryshëm për të reduktuar mundësitë për mashtrime ose gabime.

Kontrollet e autorizimit: Të gjitha transaksionet dhe veprimet e rëndësishme në departamentin e operacioneve duhet të autorizohen nga menaxherë të kualifikuar për të siguruar që vetëm veprimet e pranueshme të zbatohen.

Kontrollet fizike: Këto përfshijnë kontrollin fizik të pajisjeve dhe lëndëve të para për të parandaluar vjedhjet ose humbjet në procesin e prodhimit.

Kontrollet automatizuara: Përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit për të siguruar që të gjitha transaksionet operacionale regjistrohen saktë dhe automatikisht.

d) Duke përdorur matricën e Mendelow, klasifikoni palët e interesit të GreenTech Solutions dhe diskutoni fuqinë dhe interesin e se cilës prej tyre në vendimmarrje. (3 pikë)

**Investitorët:** Kanë fuqi të lartë dhe interes të lartë. Si burim kryesor financimi për GreenTech Solutions, ata janë të interesuar për kthimin e investimeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë. Ata ndikojnë direkt në vendimet strategjike të kompanisë.

2. **Qeveritë dhe rregulatorët:** Kanë fuqi të lartë dhe interes të mesëm. Qeveritë dhe agjencitë rregulatorë vendosin standarde mjedisore dhe rregulla për industrinë e energjisë së rinovueshme. Ndjekimi i tyre në GreenTech Solutions është i madh, veçanërisht në përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret mjedisore, por interesat e tyre janë më shumë të përqendruara te përputhshmëria sesa te çdo detaj operacional.

3. **Konsumatorët:** Kanë fuqi të ulët dhe interes të lartë. Ata janë të interesuar për produkte të qëndrueshme, me cilësi të lartë dhe me ndikim të ulët në mjedis. Edhe pse fuqia e tyre e drejtpërdrejtë është e kufizuar, preferencat e tyre ndikojnë në vendimet e GreenTech për produktet dhe strategjë e marketingut.

4. **Punonjësit:** Kanë fuqi të mesme dhe interes të lartë. Punonjësit e GreenTech Solutions janë të interesuar për kushtet e punës dhe sigurinë e tyre. Fuqia e tyre është e mesme pasi ata mund të ndikojnë në efikasitetin operativ të kompanisë dhe janë të rëndësishëm për suksesin afatgjatë.
5. **Partnerët e furnizimit:** Kanë fuqi të mesme dhe interes të mesëm. Partnerët furnizues që ofrojnë lëndët e para ose shërbime për GreenTech Solutions kanë interes për bashkëpunim të qëndrueshëm dhe çmime të qëndrueshme. Ata kanë një ndikim të konsiderueshëm në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produkteve.

e) Shpjegoni termet e qëndrueshmërisë, gjurmëve mjedisore dhe gjurmëve sociale dhe si lidhen këto koncepte me GreenTech Solutions. (3 pikë)

1. **Qëndrueshmëria:** Përfshin aftësinë e kompanisë për të operuar në një mënyrë që përmblidhet nevojat e së tashmes pa komprometuar aftësitë e gjeneratave të ardhshme. Në rastin e GreenTech Solutions, qëndrueshmëria është kyçë përmes prodhimit të energjisë së rinovueshme dhe produkteve ekologjike që ndikojnë pozitivisht në mjedis dhe shoqëri.
2. **Gjurmët Mjedisore:** Referohen në ndikimin që aktivitetet e kompanisë kanë mbi mjedisin. GreenTech Solutions duhet të jetë e vëmendshme ndaj gjurmëve të saj mjedisore, duke minimizuar emetimet e karbonit dhe duke përmirësuar efikasitetin energjetik të produkteve.
3. **Gjurmët Sociale:** Kjo përfshin ndikimin e kompanisë mbi komunitetin dhe fuqinë punëtore. Për GreenTech Solutions, gjurmët sociale mund të përfshijnë mënyrën sesi punonjësit trajtohen, përfshirjen e të drejtave të njeriut në zinxhirin e furnizimit dhe ndikimin që produktet e saj kanë mbi komunitetet ku operon.

f) Përkruani çfarë nënkupton raportimi i integruar dhe çfarë përfshijnë raportet ESG. Diskutoni si GreenTech Solutions mund t'i zbatojë këto raporte në praktikat e saj. (4 pikë)

1. **Raportimi i Integruar:** Është një metodë raportimi që kombinon informacionin financiar dhe jo-financiar për të dhënë një pamje të plotë të performancës së kompanisë. Raportimi i integruar në GreenTech Solutions do të thotë paraqitja e raportimeve financiare së bashku me informacion mbi qëndrueshmërinë, gjurmët mjedisore dhe ndikimet sociale.
2. **Raportet ESG:** Raportet ESG (Environmental, Social, and Governance) përfshijnë tre aspekte kryesore: Mjedisin, çështjet sociale dhe qeverisjen. Në kontekstin e GreenTech Solutions:
  - o **Mjedisi (E):** Raportimi për emetimet e karbonit, efikasitetin energjetik dhe ndikimet në biodiversitet.

- **Sociale (S):** Përfshin raportimin mbi të drejtat e punëtorëve, përfshirjen e komuniteteve dhe standardeve të punës në zinxhirin e furnizimit.
- **Qeverisja (G):** Përfshin transparencën, etikën dhe strukturën e qeverisjes në menaxhimin e kompanisë.

GreenTech Solutions mund të adoptojë raportet ESG për të demonstruar angazhimin e saj ndaj qëndrueshmërisë, etikës dhe përgjegjësisë sociale ndaj investitorëve, klientëve dhe palëve të tjera të interesit.

### Detyra 3

Të dhënat e Pasqyrës së Pozitës Financiare dhe Pasqyrës së të Ardhurave:

Në vijim janë paraqitur Pasqyra e Pozitës Financiare dhe Pasqyra e të Ardhurave për vitet 2022 dhe 2023 për kompaninë "NovaTech".

(Shënim: Të dhënat janë dhënë në miliona euro)

#### Pasqyra e Pozitës Financiare (në miliona euro):

Pozicioni	2022	2023
Aktivet totale	500	550
Borxhi total	300	320
Kapitali i aksionerëve	200	230
<b>Aktivet Qarkulluese</b>	150	180
<b>Inventarët</b>	50	60
<b>Detyrimet Qarkulluese</b>	100	120

#### Pasqyra e të Ardhurave (në miliona euro):

Pozicioni	2022	2023
Të ardhurat nga shitjet	600	650
Shpenzimet e interesit	40	45
Fitimi neto	50	55
Fluksi i parasë operativ	70	80

Kërkohet:

i. Llogaritni koeficientët financiarë të mëposhtëm dhe shpjegoni rëndësinë e secilit në përcaktimin e rezikut për biznesin, si dhe ndikimin e tyre tek palët e interesit:

- a) Koeficienti i Borxhit (2 pikë)
- b) Leverazhi Financiar (2 pikë)
- c) Mbulesa e Interesit (2 pikë)
- d) Koeficienti i Rrjedhës së Parasë (2 pikë)
- e) Koeficienti Qarkulluese (2 pikë)
- f) Koeficienti i Shpejtësisë (2 pikë)

ii. Modeli i Zhvillimit Moral Kognitiv të Kohlberg dhe Modeli me 5 Pyetje i Tucker:

Teoria e Zhvillimit Moral Kognitiv të Kohlberg lidhet me mënyrat se si individët marrin vendime etike, duke kaluar nëpër fazat e zhvillimit moral.

Modeli me 5 Pyetje i Tucker shqyrton vendimet korporative duke u fokusuar në pesë pyetje kritike për të analizuar vendimet etike.

Kërkohet: Duke përdorur këto dy modele, ndërtimi i një matrice për shqyrtimin e vendimeve etike të kompanisë NovaTech në situata të ndryshme. (8 pikë)

### Zgjidhja 3:

I

Koeficienti	2022	2023
Koeficienti i Borxhit	0.60	0.58
Leverazhi Financiar	2.50	2.39
Mbulesa e Interesit	2.25	2.22
Koeficienti i Rrjedhës së Parasë	0.23	0.25
Koeficienti Qarkulluese	1.5	1.5
Koeficienti i Shpejtësisë	1.0	1.0

### II) ii. Matrica e Vendimeve Etike sipas Kohlberg dhe Modelit me 5 Pyetje të Tucker:

#### 1. Modeli i Zhvillimit Moral Kognitiv të Kohlberg:

- **Faza para-konvencionale:** Në këtë fazë, vendimet etike merren për të shmangur ndëshkimin ose për të arritur përfitime personale. Në kontekstin e NovaTech, menaxhimi mund të marrë vendime për të shmangur pasojat negative financiare, duke lënë anash përgjegjësinë sociale.
- **Faza konvencionale:** Në këtë fazë, vendimet etike merren për të respektuar rregullat shoqërore dhe ligjore. NovaTech mund të marrë vendime për të përbushur rregullat dhe standartet mjedisore, duke synuar të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret.
- **Faza post-konvencionale:** Vendimet merren duke u bazuar në parime universale etike, siç janë drejtësia dhe të drejtat njerëzore. NovaTech në këtë fazë do të synonte të balancojë interesat e të gjitha palëve të interesit dhe të veprojë me përgjegjësi sociale, pavarësisht përfitimeve afatshkurtra financiare.

#### 2. Modeli me 5 Pyetje i Tucker:

- **A është e ligjshme?:** A është vendimi i NovaTech në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare? Për shembull, përdorimi i energjisë së rinovueshme duhet të jetë i ligjshëm dhe në përputhje me rregullat mjedisore.
- **A është e drejtë?:** A është vendimi i drejtë për të gjithë palët e interesit? NovaTech duhet të pyesë veten nëse vendimi i saj është i drejtë për konsumatorët, punonjësit, furnitorët dhe aksionarët. Për shembull, përdorimi i materialeve mjedisore të qëndrueshme mund të jetë më i kushtueshëm, por është i drejtë për mjedisin dhe për brezat e ardhshëm.
- **A është e moralshme?:** A është vendimi në përputhje me standartet morale të kompanisë dhe shoqërisë? NovaTech duhet të pyesë veten nëse vendimet e saj, për shembull, për të ruajtur praktikat e ndershme të punës apo për të shmangur ndotjen e mjedisit, janë moralisht të pranueshme.

- **A është e qëndrueshme?**: A mund të përballojë kompania këtë vendim në një periudhë afatgjatë? **NovaTech** duhet të pyesë veten nëse vendimi për të investuar në energji të rrinovueshme është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe nëse mund të sigurojë një kthim të qëndrueshëm për aksionarët.
  - **A është e përfitueshme?**: A do të sjellë ky vendim përfitime për kompaninë dhe palët e interesit? **NovaTech** duhet të pyesë nëse vendimet që merr për të respektuar standardet mjedisore dhe etike janë gjithashtu të përfitueshme për biznesin, duke përmirësuar reputacionin e saj dhe duke tërhequr investime afatgjata.
- 

### Përbledhje e matricës së vendimeve etike për NovaTech:

1. **Faza para-konvencionale (Kohlberg):**
    - Vendimi: Shmangia e ndëshkimeve financiare. Vendos të përbushë standardet minimale mjedisore vetëm për të shhangur gjobat.
  2. **Faza konvencionale (Kohlberg):**
    - Vendimi: Respektimi i rregullave dhe ligjeve. Vendos të ndjekë rregulloret e përcaktuara për energjinë e rrinovueshme për të përbushur standardet ligjore.
  3. **Faza post-konvencionale (Kohlberg):**
    - Vendimi: Zbatimi i parimeve universale etike. NovaTech merr vendime që synojnë një ndikim pozitiv për të gjitha palët e interesit, duke përfshirë mjedisin dhe të drejtat e njeriut.
- 

### Modeli i Tucker për shqyrtimin e vendimeve:

1. **Ligjshmëria:** NovaTech siguron që vendimet e saj për përdorimin e energjisë së rrinovueshme dhe përpunimin e produkteve të qëndrueshme janë në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. **Drejtësia:** Vendimi për të prodhuar me praktika të qëndrueshme është i drejtë për mjedisin dhe konsumatorët që kërkojnë produkte etike dhe të qëndrueshme.
3. **Moraliteti:** NovaTech synon të sigurojë praktika të moralshme duke shhangur ndotjen dhe duke respektuar të drejtat e punonjësve në të gjithë zinxhirin e furnizimit.
4. **Qëndrueshmëria:** Vendimi për të investuar në energji të rrinovueshme është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe përmirëson qëndrueshmërinë e kompanisë për një periudhë afatgjatë.

5. **Përfitimi:** Duke ndjekur praktikat e qëndrueshme dhe të moralshme, NovaTech do të përmirësojë reputacionin e saj dhe do të tërheqë investime afatgjata, duke krijuar një biznes më të fortë.

## **Detyra 4.**

### **i.) Metoda IRR**

Një kompani po konsideron të investojë në një projekt për 120,000 euro. Projekti pritet të gjenerojë të ardhura neto prej 20,000 euro çdo vit për gjashtë vite, dhe në fund të vitit 6, pritet të ketë një vlerë rishitjeje prej 10,000 euro. Politika e kompanisë është të ndërmarrë projekte që ofrojnë një kthim minimal të pritur prej 10%. Duke përdorur metodën e Normës së Brendshme të Kthimit (IRR), konstatoni nëse ky projekt duhet të pranohet. (15 pikë)

### **ii.) Kërcënimet etike për pajtueshmëri për auditorët e jashtëm në Alpha Tech**

Kërcënimet etike janë sfidat që mund të cenojnë objektivitetin dhe pavarësinë e auditorëve të jashtëm. Për auditorët e angazhuar në **Orion Tech**, përshkruani kërcënimet dhe jepni shembuj të veçantë që lidhen me situatën e tyre, duke përdorur formatin e tabelës më poshtë. (5 pikë)

**Formati i tabelës për pjesën e dytë:**

Kërcënimi Etik	Shembulli i Situatës
----------------	----------------------

Kërcënimi i vetë-rishikimit

Kërcënimi i përfitimit personal

Kërcënimi i lidhjeve familjare

Kërcënimi i intimidimit

Kërcënimi i lidhjeve të ngushta

Kërcënimi	Shembulli

**Totali 20 pikë**

**Zgjidhja 4:**

Për të llogaritur **IRR** (Normën e Brendshme të Kthimit), përdorim të dhënrat e mëposhtme për projektin:

- **Kostoja fillestare:** 120,000 euro
- **Kursimi vjetor i kostos:** 20,000 euro për 6 vite
- **Vlera e rishitjes në fund të vitit 6:** 10,000 euro

IRR llogaritet duke gjetur shkallën e interesit në të cilën **Vlera e Tanishme Neto (NPV)** bëhet zero.

Nëse IRR e llogaritur del më e madhe ose e barabartë me 10%, atëherë **Orion Tech** duhet të ndërmarrë këtë projekt.

**Përfundimi:**

Nëse IRR del më e madhe se 10%, atëherë **Orion Tech** duhet ta pranojë projektin, pasi kjo i tejkalon normën e kërkuar të kthimit. Nëse IRR është më e ulët, projekti duhet të refuzohet.

---

**ii.) Kërcënimet etike për pajtueshmëri për auditorët e jashtëm të angazhuar në Orion Tech**

**Pyetja:**

Cilat janë kërcënimet etike ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore për auditorët e jashtëm të angazhuar në **Orion Tech**? Përshkruani kërcënimet dhe jepni një shembull për secilën.

**Përgjigja:**

Auditorët e jashtëm të angazhuar në **Orion Tech** mund të përballen me kërcënime etike që cenojnë pavarësinë dhe objektivitetin e tyre. Ja disa nga kërcënimet dhe shembujt përkatës:

**Kërcënimi Etik**

**Shembulli i Situatës**

**Kërcënimi i vetë-** Auditorët janë të njëjtë që kanë ndihmuar **Orion Tech** të krijojë politikat financiare, dhe tanë po i auditojnë ato.

**Kërcënimi i personal** Auditorët marrin shpërblime shtesë nga **Orion Tech** për të dhënë përfitimit personal këshilla, duke krijuar një interes financier.

**Kërcënimi i lidhjeve** Një nga auditorët ka lidhje familjare me menaxhmentin e lartë të **Orion Tech**, gjë që cenon pavarësinë.

**Kërcënimi intimidiimit**

i Menaxhmenti i **Orion Tech** kërcenon të ndalojë bashkëpunimin me firmën e auditimit nëse raporti nuk është i favorshëm.

Kërcënimi Etik

Shembulli i Situatës

**Kërcënimi i lidhjeve** Auditorët kanë krijuar një marrëdhënie të gjatë dhe të ngushtë me ekipin menaxherial të Orion Tech, gjë që ndikon në objektivitetin.